



QENDRA ISLAMIKE KULTURORE SHQIPTARE NË NORVEGJI
ALBANSK ISLAMSK KULTURSENTER I NORGE
ALBANIAN ISLAMIC CULTURAL CENTER IN NORWAY

KUSHTET MBI FONDIN E VARRIMIT – KUFOMËS

E drejta e shfrytëzimit të fondit të kufomës vlen vetëm për anëtarët e QIKSHN'së. Personat që nuk janë anëtarë të QIKSHN'së dhe bëjnë pagesën, nuk u jepet e drejta e shfrytëzimit të këtij fondi.

Të drejtat e shfrytëzimit të këtij fondi:

- pagesa në vitin e parë e fiton 10% të drejtën e shfrytëzimit të këtij fondi
- pagesa në vitin e dytë e fiton 25% të drejtën e shfrytëzimit të këtij fondi
- pagesa në vitin e tretë e fiton 50% të drejtën e shfrytëzimit të këtij fondi
- pagesa në vitin e katër e fiton 75% të drejtën e shfrytëzimit të këtij fondi
- pagesa në vitin e pestë e më shumë e fiton 100% të drejtën e shfrytëzimit të këtij fondi

Nëse personi ka paguar rregullisht, për ç'do vit, i fiton të drejtat e shfrytëzimit të fondit sipas pasqyrës së lartpërmendur. Mos pagesa e rregullt e këtij fondi e humb të drejtën e plotë të saj, dhe duhet të filloj nga fillimi për shfrytëzimin e fondit.

Në raste kur anëtarit të QIKSHN i vjen ndonjë mysafir në vizitë paguan kr. 1.500,- për qëndrimin e tij 3-6 muaj si mysafir në këtë rast e fiton të drejtën 100%. Mysafiri duhet të dokumentojë se nuk vuan nga ndonjë sëmundje dhe të vërtetojë se posedon sigurim udhëtimi dhe sigurim shëndetësor nga shteti amë.

Kujdes!

- Nëse mysafiri është i sëmurë dhe vjen në Norvegji për rast shërimi në spital, mysafirrit nuk i jepet e drejta e shfrytëzimit të këtij fondit.
- Mysafirëve po ashtu nuk ju mbulohen shpenzimet e transportimit të kufomës në qoftë se kalojnë kufijtë e shtetit Norvegjez gjatë periudhës që ata janë mysafir në Norvegji.

Ç'farë mbulon – Fondi i Kufomës?

- Përgatitjen e kufomës sipas ritualeve fetare islame (shpenzimet e Agjencisë së Funeralit "Begravelsesbyrås" në bazë të përqindjes së shfrytëzimit të fondit)
- Përgatitjen e të gjitha dokumentacione të nevojshme (në spital, polici dhe ambasadën e shtetit amë)
- Shpenzimet e Teologut (imamit) për faljen e namazit të kufomës
- Varrimin e kufomës në një ndër varrezat më të afërta muslimane në Norvegji (në rastet kur familja dëshirojnë që varrimi i kufomës të bëhet në një komunë tjetër në Norvegji, familja duhet të mbulojë vetë shpenzimet e taksave komunale)
- Transportimin e kufomës me aeroplan nga Norvegjia deri në aeroport të vendlindjes
- Në raste epidemie/pandemie (si psh. sëmundje të rënda infektive që përhapet shpejtë midis njerëzve) QIKSHN mbulon shpenzimet deri në maksimum kr. 70.000,- inkuadruar përgatitjen dhe transportimin e kufomës brenda Norvegjisë ose transportin për në vendlindje deri në aeroport të vendlindjes. Të gjitha shpenzimet në raste që tejkalojnë shumën maksimale kr. 70.000,- familjarët e afërt të personit që ndron jetë janë të obliguar që t'i mbulojnë vetë shpenzimet shtesë.

Në raste udhëtimi jashtë Norvegjisë, anëtarët janë të obliguar të posedojnë sigurim udhëtimi dhe sigurim shëndetësor pasi që «Fondi i Kufomës» nuk mbulon transportimin e kufomës jashtë kufijve të Norvegji.

Adresse:
Sverres gate 8
0652 OSLO

Org. nr.:
9756 11 515

Telefon:
+47 22353372

Web:
qiksh.no

E-post:
adm@qiksh.no



QENDRA ISLAMIKE KULTURORE SHQIPTARE NË NORVEGJI
ALBANSK ISLAMSK KULTURSENTER I NORGE
ALBANIAN ISLAMIC CULTURAL CENTER IN NORWAY

Ç'farë nuk mbulon - Fondi i Kufomës?

- Transportimin e kufomës nga një shtet jashtë Norvegjisë për në Norvegji apo për në vendlindje. Në raste të tilla familja e afërt është e obliguar të sigurojë transportimin e kufomës prej një shteti tjetër për në Norvegji apo për në vendlindje
- Shpenzimet e udhëtimit për shoqërues/ndjekës të kufomës apo anëtar tjetër të familjes për në vendlindje
- Transportimin e kufomës prej aeroportit në vendlindje deri në shtëpinë- apo banesën e kufomës në vendlindje
- Asnjë lloj dëmshpërblimi tjetër për anëtarët e ngushtë të familjes
- Përgatitjen, varrimin, transportin apo shpenzime tjera rreth përgatitjes së kufomës/varrimit në qoftë se anëtari ndërron jetë në vendlindjen e tij
- Shpenzimet e shërbimeve tjera shtesë (si rezervim të vendit të varrezat për anëtarët tjerë të familjes, shpenzimet e gurëve të varrit apo dekorime të ndryshme rreth varrit, etj.)
- QIKSHN nuk bënë asnjë lloji kompensimi të të hollave në raste kur NAV-i mbulon një pjesë të shpenzimeve të kufomës, Byrosë për Funeral "Begravelsesbyrå'se"
- Në raste epidemie/pandemie (si psh. sëmundje të rënda infektive që përhapet shpejtë midis njerëzve) QIKSHN nuk mbulon shpenzimet që tejkalojnë shumën maksimale mbi kr. 70.000,- inkuadruar përgatitjen dhe transportimin e kufomës qoftë brenda Norvegjisë apo transportin e kufomës për në vendlindje.
- Në raste epidemie/pandemie (si psh. sëmundje të rënda infektive që përhapet shpejtë midis njerëzve) ku si pasojë e epidemisë/pandemisë është e pamundur transportimi i kufomës për në vendlindje, QIKSHN nuk mban përgjegjësi për organizimin dhe sigurimin e transportimit të kufomës për në vendlindje dhe familjarët e afërt të personit që ndron jetë janë të obliguar që organizimin dhe transportim e kufomës ta bëjnë vetë.

SI DUHET VEPRUAR NË RAST VDEKJE TË NDOJË ANËTARIT TË FAMILJES?

Në rast vdekje të ndonjë anëtari të familjes ju së pari duhet të kontaktoni QIKSHN-in në tel. **22 35 33 72** ose mob. **974 66 371** (prej orës 08.00 – 18.00).

Në qoftë se rasti ndodhë në banesë/shtëpi ju duhet së pari të kontaktoni me ndihmën e shpejtë në telefon **113** dhe pastaj të lajmëroni rastin te ne ose direkt tek agjencia e funeralit.

Në raste urgjente ju mund të kontaktoni me bashkëpunëtorin tonë, agjencinë e funeralit (Begravelsesbyrået) "**Al-Khidmat**" në telefonin kujdestar **408 33 333** (i hapur 24 orë) ose vizitoni webfaqen www.alkhidmat.no

Nëse ju kontaktoni direkt me agjencinë e funeralit "**Al-Khidmat**", është me rëndësi që t'i informoni ata të byrosë, se jeni anëtar i qendrës sonë dhe pastaj të na lajmëroni edhe ne për rastin.

Pas kontaktimit, QIKSHN-i ka përgjegjësinë për organizimin dhe angazhimin e:

- Agjencisë së Funeralit "Begravelsesbyrås" për përgatitjen e kufomës sipas ritualeve fetare islame
- Teologun (imamin) për faljen e namazit të kufomës
- Varrimin e kufomës në një ndër varrezat më të afërta muslimane në Norvegji ose
- Transportimin e kufomës me aeroplan nga Norvegjia deri në vendlindje (deri në aeroport)

Adresse:
Sverres gate 8
0652 OSLO

Org. nr.:
9756 11 515

Telefon:
+47 22353372

Web:
qiksh.no

E-post:
adm@qiksh.no



QENDRA ISLAMIKE KULTURORE SHQIPTARE NË NORVEGJI
ALBANSK ISLAMSK KULTURSENTER I NORGE
ALBANIAN ISLAMIC CULTURAL CENTER IN NORWAY

Kujdes!

Anëtarët, të cilët i kanë ndryshuar adresat e banimit ose planifikojnë ti ndryshojnë brenda vitit, ju lutemi që të informojnë QIKSHN-in sa më shpejt që të jetë e mundur që ne të bëjmë azhurnimin e adresës suaj.

Njëkohësisht ju lusim që të na informoni nëse keni ndonjë ndryshim të numrit të anëtarëve (psh. nëse ju është shtuar ndonjë anëtarë të rinj i familjes).

Regjistrimi i anëtarëve të ri mund të bëhet direkt në faqen tonë të internetit

www.qiksh.no/anetarsohu (për personat mbi 18 vjet) dhe

www.qiksh.no/anetarsohu/anetarsim-te-femijeve (për personat ndër 18 vjet) ose duke dërguar e-post tek: adm@qiksh.no

Gjatë anëtarësimit të ndonjë anëtari të ri është më se e domosdoshme që të jepni të dhënat personale të sakta (emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen (11 shifra), adresën, nr. postal, vendin/qytetin, numrin e mobilit/telefonit dhe e-post adresën).